



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:290597

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759483

P.nr. 380/2023

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm-Divisioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari, në çështjen penale kundër të pandehurit U.M., në adresë fshati Sllapuzhan komuna Suharekë, për veprën penale vjedhja nga neni 313 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, sipas aktakuzës PP/II.nr. 1723-11/23, të dt. 20.12.2023, jashtë seancës me datë 30.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër NDM.nr. 16/2024, e arritur me datën 30.05.2024, nga ndërmjetësi A.R., nga Prizreni, nga palët: I pandehurit U.M., dhe i dëmtuari B.K.,.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 1723-11/23, të dt. 20.12.2023, **PUSHON** procedura penale kundër të pandehurit U.M., i lindur me, me numër të letërnjoftimit, për veprën penale vjedhja nga neni 313 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Gjykata sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt. 22. 05.2024, në të cilën seancë i pandehuri ka propozuar që të aprovohet kërkesa e tij, në mënyrë që kjo çështje penale të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit. Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari nuk e kanë kundërshtuar propozimin e të pandehurit dhe në këtë seancë janë pajtuar që kjo çështje juridike penale të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit.

Pas parashtrimit të propozimit të pandehurit dhe pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata ka marrë aktvendim dhe ka aprovuar kërkesën e të pandehurit, me ç'rast të gjitha shkresat e lëndës i'a ka dorëzuar institucionit të ndërmjetësimit, të cilët kanë negociuar

marrëvshjen e ndërmjetësuar në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmjetësim 06/L-009.

Me datë 30.05.2024 në degën e gjykatës në Suharekë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e rastit me ndërmjetësim me numër NDM nr. 16/2024, ku është arritur marrëveshja për zgjidhje të ndërmjetësuar në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit.

I pandehuri ka deklaruar se ketë marrëveshje e lidhin me vullnet të plotë pa shtërngimi nga askush se i vie keq për rastin që ka ndodhur, i kërkon falje të dëmtuarit, ndihet e penduar, dhe premtion se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla të kundërligjore dhe tërhiqet prej fajlëve të tij që i ka përmendur ndaj të dëmtuarit, ndërsa i dëmtuari ka deklaruar se ketë marrëveshje e lidhin me vullnet të plotë pa shtërngimi nga askush pranon kërkimin faljen nga i pandehuri, heq dorë nga ndjekja penale dhe sa i përket kesaj çështje nuk kërkon kompenzim të dëmit.

Palët pa ndonjë shtytje dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, dhe nuk e kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura të shprehura në marrëveshjen me numër Ndm.nr.16/2024 të datës 30.05.2024, e ndërmjetësuar nga ndërmjetësi n A.R., nga Prizreni, dhe të aprovuar këtë marrëveshje të ndërmjetësimit nga ana e gjykatës, dhe kjo marrëveshje e ndërmjetësimit e ka fuqinë e titullit ekzekutiv përmbarues.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenev 229 dhe 357 par.1 nën paragraf. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032, dhe nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Ndërmjetësim 06/L-009, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar në kuptim të nenit 453 par. 1. të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 380/2023 dt. 30.05.2024

Gjyqtari
Lavdim Bajraktari

KESHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditëve Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate.